FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 16	2002	Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8881 datë 18.4.2002	Për ratifikimin e "Kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e rrugëve europiane- Shqipëria"	475
Ligj nr.8882 datë 18.4.2002	Për ratifikimin e "Protokollit shtesë të "Marrëveshjes Europiane për transmetimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore dhe të raportit shpjegues""……..	492
Vendim i Kuvendit nr. 29, datë 25.4.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 25, datë 15.4.2002 "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm për shqyrtimin e projektligjeve të paraqitura në Kuvend për problemet e pronave"…… ……..	499
Vendim i Kuvendit nr. 30, datë 30.4. 2002	Për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit ……	500
Dekret nr. 3316 datë 29.4.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare ……	500

Vendim i KM nr.132, datë 13.4.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 69, datë 11.2.1999 të Këshillit të Ministrave "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë"……	501
Vendim i KM nr. 133, datë 13.4.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 317, datë 8.7.1999 të Këshillit të Ministrave "Për shpërblimin e punës së punonjësve", ndryshuar me vendimet nr.261, datë 25.5.2000 dhe nr. 36, datë 20.1.2001…….	502
Vendim i KM nr. 135, datë 13.4.2002	Për disa shtesa në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore ", me ndryshimet përkatëse……..	503
Vendim i KM nr. 144, datë 19.4.2002	Për shitjen e materialeve të krijuara nga nxjerrja jashtë përdorimit e disa armëve të këmbësorisë, në administrim të forcave të armatosura……..	504

LIGJ
Nr.8881, datë 18.4.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONTRATËS FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE PËR PROJEKTIN E RRUGËVE EUROPIANE - SHQIPËRIA"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Kontrata financiare për shumën 34 000 000 (tridhjetekatër milionë) euro ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e rrugëve europiane - Shqipëria".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3312, datë 29.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.8882, datë 18.4.2002

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT SHTESË TË "MARRËVESHJES EUROPIANE PËR TRANSMETIMIN E KËRKESAVE PËR NDIHMË GJYQËSORE DHE TË RAPORTIT SHPJEGUES""

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli shtesë i "Marrëveshjes europiane për transmetimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore dhe raporti shpjegues"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3313, datë 29.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr.29, datë 25.4.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.25, DATË 15.4.2002 "PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR SHQYRTIMIN E PROJEKTLIGJEVE TË PARAQITURA NË KUVEND PËR PROBLEMET E PRONARËVE"

Në mbështetje të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit.

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në pikën III të vendimit të Kuvendit nr.25, datë 15.4.2002 "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm për shqyrtimin e projektligjeve të paraqitura në Kuvendin për problemet e pronave", deputeti Niko Faber zëvendëson në përbërje të Komisionit deputetin Spartak Braho.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Namik Dokle

V E N D I M
Nr.30, datë 30.4.2002

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 75 dhe 78 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Zoti Servet Pëllumbi zgjidhet në detyrën e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Makbule Çeço

DEKRET
Nr.3316, datë 29.4.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënja e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të më poshtëm:

1. Dritan Marash Luka
2. Violeta Pandeli Luzi
3. Ismet Halil Kulheku
4. Matthias Ismet Kulheku
5. Suzana Ismail Kulheku (Sulejmeni)
6. Vilma Ismet Kulheku
7. Orgeta Ismet Kulheku
8. Gjergji Muharem Xhafaj
9. Dhurata Nazmi Lina (Lleshi)
10. Antoneta Jaho Asllani-Chmielnik
11. Fatmir Gani Tema
12. Hajredin Muhamet Hyshtra
13. Valdino Hajredin Hyshtra
14. Valdete Xhelal Hyshtra (Kombi)
15. Agron Uan Goreja
16. Kasandro Agron Goreja
17. Xhuljana Parit Karruku (Derani)
18. Daniela Edmond Karruku
19. Ornella Edmond Karruku
20. Lorenc Qazim Zorba
21. Alfred Beqir Genci
22. Ylli Shaqir Kenga
23. Bardhyl Riza Karagjozi
24. Riviera Zija Karagjozi (Çela)
25. Mirjana Ibrahim Stahlmann (Halili)
26. Adrian Petraq Baku
27. Valentina Masar Uka
28. Dritan Masar Uka
29. Arben Rexhep Rrojka
30. Angie Arben Rrojka
31. Irta Seid Rrojka (Uzuni)
32. Leonard Demir Ibrahimi
33. Kaysi Leonard Ibrahimi
34. Edmond Leonard Ibrahimi
35. Akilina Selam Ibrahimi (Nanaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

Presidenti i republikës së shqipërisë

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rerxhep Meidani

V E N D I M
Nr.132, datë 13.4.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.69, DATË 11.2.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 2, të vendimit nr.69, datë 11.2.1999, të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

- Në paragrafin e parë shprehja "subvencionon të menjëhershëm" të zëvendësohet me shprehjen "financim mujor".

Në paragrafin e dytë pas fjalës "vendimi" fjalia ndryshon si më poshtë vijon:

"…financimi bëhet çdo muaj për një periudhë deri në 3 muaj".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.133, datë 13.4.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.317, DATË 8.7.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.261, DATË 25.5.2000 DHE NR.36, DATË 20.1.2001

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.317, datë 8.7.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1.Paragrafi i tretë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme deri në 1:7, por jo më shumë se paga e kategorisë II-b, e lidhjes nr.1, e vendimit nr.711, datë 27.12.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunëse civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".

Për ndërmarrjet e mëdha dhe strategjike, jo më e lartë se paga e kategorisë I-b, e lidhjes nr.1, e vendimit nr.711, datë 27.12.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndyshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".

2.Në pikën 8, shprehja "me klasifikimin A9, të miratuar me vendimin nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave,. "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", zëvendësohet me shprehjen:

"me kategorinë I-b, të lidhjes nr.1, të miratuar me vendimin nr.711, datë 27,12,2001, të Këshillit të Ministrave".

Ky vendim hyn në fudi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.135, datë 13.4.2002

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE ", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a)Në lidhjen I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", në shkronjën B1 shtohet emërtimi "Kryetari i Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike".

b)Shtohet lidhja II-28 me emërtimin "Nivelet e pagës për punonjësit e Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike", e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Efektet financiare, që rrjedhin ngazbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja II -28

Nivelet e pagës për punonjësit e agjencisë së inventarizimit dhe transferimit të pronave publike

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi	
Kryetari i Agjencisë…….		B1	
Nr.	Emërtimi i punonjësit	Niveli i Pagës	
		Klasa	Shtesa për funksion (grupi)
1.Përgjegjës sektori……..		X	6
2.Specialist në qendër dhe qark ……..		IX	

Shënim: Për punonjësit e tjerë zbatohen pagat sipas Lihjes II-5 "Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore", të këtij vendimi

V E N D I M
Nr.144, datë 19.4.2002

PËR SHITJEN E MATERIALEVE TË KRIJUARA NGA NXJERRJA JASHTË PËRDORIMIT E DISA ARMËVE TË KËMBËSORISË, NË ADMINISTRIM TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 7, të nenit 14, të ligjit nr.8671, datë 26.10.2001, "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive priate, të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes t'i shesë, pa andkand, shoqërisë "KURUM, Internacional", shpk, sasinë prej 1528,9 tonësh të materialeve të krijuara nga nxjerrja jashtë përdorimit e disa armëve

të këmbësorisë, në administrim të Forcave të Armatosura.

2.Çmimi i shitjes së këtyre materialeve të miratohet nga ministri i Mbrojtjes.

3.Shuma e përfituar nga shitja e këtyre materialeve të përdoret sipas kritereve të përcaktuara në vendimin nr.424, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".

4.Ngarkohet ministri i Mbrojtjes të nxjerrë urdhërat dhe udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

ANEKSI A
Çmimi i shitjes së Skrapit të vendndodhjes

Repartet	Prefektura	Sasia në ton	Transporti	Çmimi lekë/kg (pa TVSH)
Rep.usht.8800	Tiranë	25	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.3400	Tiranë	868	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.5011	Tiranë	46	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.2001	Durrës	60	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.5012	Elbasan	250	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.1100	Shkodër	70	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.2200	Kukës	19	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.3300	Burrel	30	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.4400	Korçë	70	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.5500	Gjirokastër	30	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.6600	Fier	40	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.5014	Rrëshen	20	Kurum sh.p.k.	3.5

Nr	Armatimi	Copë	Ton	1100	2200	3300	4400	5500	6600	7700	8800	2001	34
1	Mitraloz 14.5 mm -4	33	1.45	3		4	5	1	4		3	6	7
2	" 14.5 mm -2	177	0.45	28		6	39	15	65	24			
3	" 14.5 mm-2 anie	20	0.45									20	
4	Mortajë 107 mm md-38	13	0.25						12				
5	" 120 mm md-55	2	0.175										
6	Top 76 mm md-43	14	0.45						2			2	
7	Top 76 mm md-54	82	0.80	17		1	18	19	2	4			
8	" 85 mm md-56	21	1.20	18				2		1			
9	" 100 mm md-54	9	2.55						1			8	
10	" 122 mm md-60	2	3.70				1						
11	" 107 mm reaktiv	14	0.3								14		
12	MLR 132 mm md-63	8	4.27		1				4	4			
13	Top 100 mm Br T.M	8	6.47						4			4	
14	" 130 mm Br T.M	4	12.77						4				
15	" 37 mm K.A md 55	53	1.47	32		6	12						3
16	" 37 mm K.A md 65	40	1.80	6		6	6			6	12	3	1
17	" 37 mm K.A-1 anie	5	1.47									3	
18	" 37 mm K.A-2 anie	1	1.80										
19	" 57 mm K.A md-59	96	3.40										96
20	" 100 mm K.A md-59	87	6.47										87
21	" 40 mm K.A Turk	28	1.40		18				10				
22	" 20 mm K.A Turk anie	20	-.30										
23	" 20 mm Gjerman	1	0.30										
24	" 45 mm anie	8	0.45									8	
25	" 85 mm anie	2	1.20									2	
26	Armë të	82000	0.0025	8									

	ndry.këmbësorie												
	SHUMA	748		104	19	23	81	37	108	39	29	56	19

Tabela me sasuitë e armëve të dala jashtë përdorimit dhe sasia e skrapit të përfituar

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 14. 5. 2002
Doli nga shtypi më 15. 5. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë